

KOMITETI DREJTUES

Tiranë, 20 prill 2023

Nr. 30 Prot.

Vendim Nr.3 i KD-së

Kryesia e Federatës Shqiptare të Basketbollit e mbledhur më datë 20.04.2023, drejtuar nga Presidenti i FSHB-së, Z. Avni Ponari dhe prezencë të anëtarëve, Znj. Edera Alibegaj, Znj. Migena Plasa, Z. Juel Jarani, Z. Blendi Dibra dhe Z. Klevis Kaso, diskutuan mbi ngjarjen e ndodhur pas ndeshjes së dytë ½ finale Kategoria I-re femra, Partizani vs SK Tirana, duke marrë për bazë situatën e krijuar dhe relatin nga zyrtarët e ndeshjes.

Në përfundimin e ndeshjes kur gjyqtarët po i drejtoheshin dhomave të ndërrimit, pati incidente midis dy ekipeve duke cënuar integritetin e kampionatit kombëtar të femrave dhe imazhin e sajë në publik. Vëzhguesi Teknik i ndeshjes ka reaktuar për situatën kaotike dhe të pa denjë duke pikasur aq sa mundej për rrjedhën e ngjarjeve. Për këtë ngjarje ai është thirrur nga Komisioni i Disiplinës ku ka sqaruar dhe më tepër mbi informacionet rreth kësaj ngjarje. Ndeshja, pavarësisht nivelit të lartë sportiv, nuk është transmetuar nga televizionet në Shqipëri duke e lënë ndeshjen e Play Off në terr mediatik. Mungesa e pamjeve filmike të plota ka penguar Komisionin e Disiplinës të krijojë një pamje më të detajuar të ngjarjes. Vendimi i Komisionit të Disiplinës është marrë në funksion të relatin zyrtar të ndeshjes.

Për sa më sipër KD-ja vendosi:

1. Mbështetjen e vendimit të komisionit të disiplinës, datë 20.04.2023, nr.29 prot., lidhur me ngjarjen e ndodhur në përfundim të ndeshjes së dytë ½ finale Kategoria I-re femra, Partizani vs SK Tirana. Në vendim paraqitet ndëshkim i shoqatës "Partizani Basket" për dështimin në masat e sigurisë dhe ndëshkim të lojtareve të përfshira në sjelljet antisportive.
2. Deklaratë për shtyp për publikun duke kërkuar ndjesë dhe dënuar ngjarjen e ndodhur e cila ka cënuar imazhin sportiv dhe vlerat e respektit ndërnjerzor me sjellje të pa denja për një garë sportive.

Ky vendim hyn në fuqi në datën 20.04.2023 dhe i bëhet e njohur për shoqatat anëtare dhe publikun.